



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.5.2023

Nr: 522

Ora: 09:00

VENDIM

PËR

**PAJISJEN E QENDRËS SË VOTIMIT NR. 3209/1, KZAZ NR. 58, BASHKIA FIER, ME SASINË SHITESË TË FLETËVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 43, nenit 62, pika 2, nenit 93, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Sipas komunikimit me Komisionin e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve nr. 58, Bashkia Fier, në qendrën e votimit nr. 3209/1, ka mungesë të 250 (dyqind e pesëdhjetë) fletëve të votimit për këshill dhe do t'i tërheqë nga qendra e votimit nr. 3209.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të autorizojë KZAZ nr. 58, Bashkia Fier, që të tërheqë nga qendrat e votimit nr. 3209 fletë votimi për këshill. Në këto kushte, KQZ duhet të marrë masa të sigurojë sasi shtesë të fletëve të votimi për të mundësuar votimin për këshill.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.5.2023 Nr: 522  
Ora: 09:00



“Për pajisjen e qendrës të votimit nr. 3209/1, KZAZ nr. 58, Bashkia Fier, me sasinë shtesë të fletëve të votimit për këshill, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

## V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ-së nr. 58, Bashkia Fier, që të pajisë me sasinë shtesë të fletëve të votimit, qendrën e votimit nr. 3209/1.
2. Autorizimin e KZAZ-së nr. 58, Bashkia Fier, të pajisë me 250 (dyqind e pesëdhjetë) fletë votimi për këshill. Sasia shtesë e fletëve të votimit do të merret nga qendra e votimit nr. 3209, të KZAZ-së nr. 58.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**